



VENDIMI DHE GJETJET

Data e miratimit: 5 dhjetor 2017

Nr. i lëndës: 2011-27

F. dhe të Tjerë

kundër

EULEX-it

Teksti i vendimit të miratuar nga Paneli më 5 dhjetor 2017 u redaktua nga shefja e Misionit, duke shfrytëzuar kompetencat e saj sipas planit operacional (OPLAN-i) për misionin e Bashkimit Evropian të sundimit të ligjit në Kosovë. Shefja e Misionit ka konsideruar se teksti origjinal i vendimit mund të ndikoj në efektivitetin operacional të Misionit.



VENDIMI DHE GJETJET

Data e miratimit: 5 dhjetor 2017

Nr. i lëndës: 2011-27

F. dhe të Tjerë

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 5 dhjetor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit me 15 janar 2013,

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa në emër të bashkëshortes dhe dy anëtarëve të familjes së të ndjerit X.F. ishte paraqitur në Panel me datën 14 nëntor 2011. Paneli ka miratuar kërkesën e paraqituesit të ankesës që emrat e tyre mos të zbulohen. Në vijim ata do të përmenden si "F. dhe të Tjerë".
2. Paneli i ka komunikuar ankesën shefit të Misionit (ShM-së) me datën 16 tetor 2012 dhe ka kërkuar nga ai që të ofrojë komente me shkrim mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e lëndës.
3. Më 17 janar 2013, ShM-ja ka ofruar komentet lidhur me pranueshmërinë e lëndës.

4. Më 9 prill 2013, një zyrtar i caktuar nga Misioni gojarisht i ka prezantuar Panelit faktet e caktuara që lidhen me zgjidhjen e ankesës.
5. Më 15 korrik 2015, Paneli i ka ofruar avokatit të ankuesve një kopje të një versioni të redaktuar të këtij prezantimi së bashku me një kërkesë për komentet e tij. Përgjigjja e ankuesit ishte paraqitur në Paneli më 27 korrik 2015.
6. Më 30 tetor 2015, EULEX-it i ka paraqitur Panelit një raport të shqyrtimit të lëndës që në ndërkohë ishte kryer.
7. Në dy raste në vitin 2016, ShM-ja ka paraqitur parashtrësia të mëtejshme për rastin, duke tërhequr vëmendjen Panelit në faktin se parashtrësit e Misionit ishin konsideruar dokumente jopublike të BE-së dhe/ose mund të ndikojnë negativisht në procedimet penale në vazhdim.
8. Prandaj Panelit i janë paraqitur parashtrimet e Misionit, tekstin e plotë të të cilit nuk mund t'ia transmetonte ankuesit për komentet e tij. Në vendimin e tij të pranueshmërisë të datës 13 qershor 2017, Paneli shqyrtoi çështjet procedurale që ngritën në rastin në lidhje me këtë.
9. Paneli është i bindur që procedura vijuese ka ruajtur ekuilibrin e duhur midis të drejtës procedurale të ankuesve për të paraqitur argumentet lidhur me çështjen e tyre në mënyrë efektive dhe nevojës për të ruajtur konfidencialitetin e disa aspekteve të operimit të Misionit në fusha të ndjeshme (shih vendimin e pranueshmërisë të datës 13 qershor 2017 në këtë rast, përmendur më lartë, paragrafi 11-21).
10. Në këtë vendim Paneli në veçanti theksoj se mund të përdorte procedurën, përmes së cilës iu ishte dhënë qasje e plotë në informatat e ofruara nga Misioni, duke përfshirë informacionin që konsiderohej tepër i ndjeshëm për t'iu zbuluar parashtrësit të ankesës dhe publikut në funksion të sigurisë operationale. Përdorimi i Panelit nuk është i lirë të zbulojë elemente të caktuara të këtij informacioni ankuesit ose t'i bëjë ato elemente publike, ky fakt nuk e pengon Panelin që të kryejë një shqyrtim të plotë të çështjeve të përfshira në këtë rast. Për më tepër, Paneli është bindur se pamundësia e tij për ta zbuluar atë informacion tek ankuesi në tërësinë e tij nuk do të pengonte aftësinë e tij për të kërkuar një zgjidhje efektive para Panelit. Prandaj, Paneli arriti në përfundimin se parashtrimi i plotë i Misionit ishte shqyrtuar në hollësi në vendimin e pranueshmërisë në përputhje me standardet për gjykim të drejtë, se nuk ishte i autorizuar t'ia shpallë parashtrësën e plotë ankuesit dhe se Paneli mund të kryejë funksionet e veta mbi këtë bazë.
11. Paneli ka përdorur një qasje të ngjashme procedurale në një rast kur ShM-ja ka kërkuar që një pjesë e informacionit që i ishte dhënë Panelit duhet të mbetet konfidenciale. ShM-ja i siguroj Panelit një version të shkurtuar, të redaktuar të parashtrësive të tij me qëllim të informimit të parashtrësit të ankesës dhe publikut të gjerë rreth përmbajtjes së parashtrësive të tij. Prandaj, Paneli ishte bindur se ankuesi nuk është dëmtuar nga fakti se ai ka marrë vetëm një version të përmbledhur të parashtrësive të ShM-së (shih *Maloku kundër EULEX-it*, nr. 2015-04, 10 janar 2017, paragrafi 5).
12. Të njëjtat shqyrtime procedurale janë zbatuar nga Paneli gjatë shqyrtimit të rastit të çështjes për shqyrtimin e bazueshmërisë.

II. PËRMBLEDHJE E FAKTEVE

13. Faktet e rastit të pranuar në bazë të parashtrësive të palëve të bëra në procedurën siç përshkruhet në par. 1-12 më lartë, mund të përmbledhen si më poshtë:
14. X.F. ishte dëshmitar i prokurorisë në një rast kryesor penal që kishte të bënte me akuza të rënda që ishin ngritur ndaj dhjetë (10) individëve që ishin duke u hetuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës.
15. X.F. ishte sulmuar dhe plagosur nga persona të paidentifikuar në oborrin e shtëpisë së tij në vitin 2009. Ka pasur gjithsej gjashtë (6) tentim atentate ndaj tij nga autorë që mbetën të panjohur.
16. X.F., F. dhe fëmijët e tyre u pranuan në programin për mbrojtën e dëshmitarëve të EULEX-it në dhjetor 2009. Ankuesit pohojnë se kushtet e tyre gjatë programit ishin shumë të vështira.
17. ShM-ja i mohoi këto pohime.
18. Në dhjetor të vitit 2010, familja u largua vullnetarisht nga programi, me sa duket për shkak të presionit të ushtruar ndaj X.F. nga gruaja e tij, e cila ishte e pakënaqur me jetën që po bënte familja përderisa ishte nën mbrojtjen e zyrtarëve të programit të mbrojtjes. Pavarësisht daljes nga programi i mbrojtjes, X.F. ende dëshironte të dëshmonte në lidhje me këtë rast.
19. Në një datë të pasaktësuar të vitit 2011, ishte kryer një vlerësim i rrezikut nga EULEX-i. Ishte zbuluar se rreziku i sulmit kundër X.F. dhe familjes së tij mbetej i lartë.
20. Në muajt e parë të vitit 2011, një numër arrestimesh ishin kryer në lidhje me lëndën penale të përmendur më lartë.
21. Për X.F. ishte rregulluar që të udhëtonte drejt një shteti anëtar të BE-së, me një njoftim të shpejtë. Një prokuror i EULEX-it informoj autoritetet e shtetit anëtar të BE-së lidhur me të një moment derisa F. ishte rrugës. Një shumë e caktuar e parave ishte caktuar nga fondet e Misionit për të financuar qëndrimin e X.F. në shtetin anëtar të BE-së, ku ai kishte lidhje familjare.
22. Në një datë të pasaktësuar, autoritetet e një shteti anëtar të BE-së ishte informuar për praninë e X.F. në shtetin anëtar të BE-së.
23. Në korrik 2011, X.F. ishte kthyer në Kosovë ku ai kishte dhënë deklarata në seancën paraprake gjyqësore në rastin e lartpërmendur. Më pas ai ishte pranuar rishtas në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve të EULEX-it në mënyrë që të merrte ndihmë financiare dhe ndihma të tjera nga programi.
24. Menjëherë pas kësaj ai ishte kthyer në shtetin anëtar të BE-së (i shoqëruar nga EULEX-i Kosovë)
25. Më 28 shtator 2011, X.F. vdiq në shtetin anëtar të BE-së. Një hetim i kryer nga policia e shtetit anëtar të BE-së përcaktoj se ai kishte kryer vetëvrasje.
26. Procedurat penale ndaj të pandehurve në lëndën penale të përmendur më lartë më vonë ishin kryer në gjykatat e Kosovës. Në vitin 2013 Gjykata Themelore e Prishtinës dha gjykimin e saj. Të gjithë të pandehurit ishin liruar.

27. Prokurori i EULEX-it bëri ankesë ndaj këtij aktgjykimin. Në vitin 2016, Gjykata e Apelit e hodhi poshtë atë ankesë.
28. Më pas, Prokurori i EULEX-it pranë Zyrës së Prokurorit të Shtetit paraqiti një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ndaj këtij aktgjykimi. Në vitin 2017, Gjykata Supreme e Kosovës hodhi poshtë ankimimin e prokurorit.

III. ANKESAT

29. Ankuesit më tutje pohojnë se presioni psikologjik që i ishte nënshtruar X.F., si dhe trajtimi i tij i përgjithshëm nga EULEX-i dhe izolimi i tij nga familja gjatë kohës sa ishte në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe më vonë në shtetin anëtar të BE-së, e kishte çuar në kryerjen e vetëvrasjes. Pretendohet se EULEX-i ishte në dijeni për gjendjen e tij mendore, por nuk arriti të ndërmerre hapa të duhura për të parandaluar vdekjen e tij. Ankuesit kërkojnë që personat përgjegjës për shkeljet e pretenduara të të drejtave të familjes së tyre dhe vdekjen e X.F. të sillen para drejtësisë.

IV. LIGJI

30. Ankuesit pohojnë se EULEX-i ka qenë në dijeni lidhur me gjendjen mendore të tij dhe se nuk i kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm për ta parandaluar vdekjen e tij. Ata kërkojnë që personat përgjegjës për shkeljet e pretenduara të drejtave të familjes F. dhe vdekjen e X.F. të sillen para drejtësisë. Për më shumë ata ankohen se Misioni nuk i ka ndërmarrë masat e duhura për ta mbrojtur jetën e X.F. dhe se nuk i ka hetuar rrethanat që kanë çuar deri te vdekja e tij.
31. ShM-ja nuk është pajtuar.
32. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
33. Paneli e ka shpallur të pranueshme ankesën e parashtruar nga ankuesit sipas nenit 2 dhe 3 të Konventës, të cilat për aq sa janë relevante përcaktojnë:

Neni 2

"1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i privohet qëllimisht jeta, me përjashtim të rastit, kur zbatohet një vendim me vdekje i dhënë nga një gjykatë, kur krimi ndëshkohet me këtë dënim nga ligji. [...]"

Neni 3

"Askush nuk mund t'i nënshtrohet ... trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese ..."

34. Në vendimin e tij për pranueshmërinë lidhur me këtë rast, Paneli deklaroi se ankesat që kishin të bënin me faktet lidhur me pjesëmarrjen e familjes F. në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve janë të papranueshme pasi që ato bien jashtë afatit

gjashtëmuor të paraparë me rregullën 25, par. 3 të Rregullores së tij të punës. Më tej, Paneli e rezervon të drejtën e tij për t'i marrë këto fakte parasysht vetëm si informata lidhur me këtë rast në kontekstin e shqyrtimit të aspekteve të papërfunduara të tij. Paneli do të udhëhiqet nga vendimi i cekur i pranueshmërisë gjatë shqyrtimit të këtij rasti në fazën e tanishme të procedurave.

Neni 2 i Konventës

35. Fjalja e parë e nenit 2 që radhitet si një prej dispozitave më themelore të Konventës dhe po ashtu mbron një prej vlerave bazike të shoqërive demokratike, e udhëzon shtetin që jo vetëm të përmbahet nga marrja “me qëllim” e jetës, por edhe të ndërmer hapa të duhura për ruajtjen e jetës së atyre që janë nën juridiksionin e tij (shih, në mesin e shumë autoriteteve të tjera, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), *Dodov kundër Bullgarisë*, nr. 59548/00, § 79, 17 janar 2008).
36. Obligimi pozitiv i Shtetit i përcaktuar në nenin 2 është konstatuar se ishte zbatuar në rrethana të ndryshme, si në sektorin e kujdesit shëndetësor, qoftë ai publik apo privat, sa i përket veprimeve apo mosveprimeve të profesionistëve shëndetësorë (shih GjEDNj, *Dodov kundër Bullgarisë*, cituar më lartë, §§ 70, 79-83 dhe 87, GjEDNj 2008-...; *Byrzykowski kundër Polonisë*, nr. 11562/05, §§ 104 dhe 106, 27 qershor 2006) si dhe në lidhje me menaxhimin e veprimtarive të rrezikshme (shih GjEDNj, *Öneryıldız kundër Turqisë* [GC], nr. 48939/99, § 71, GjEDNj 2004-XII) dhe sigurimin e sigurisë në anije (shih GjEDNj, *Leray dhe të tjerët kundër Francës* (vendim), nr. 44617/98, 16 janar 2001) apo në vend punime ndërtimi (shih GjEDNj, *Pereira Henriques dhe të tjerët kundër Luksemburgut* (ven.), nr. 60255/00, 26 gusht 2003). Në rrethana të caktuara, obligimet pozitive mund t'i shtohen shtetit për mbrojtjen e individëve edhe nga rreziku ndaj jetës së tyre që vjen si rezultat i veprimeve apo sjelljeve të veta individuale (shih GjEDNj, *Bone kundër Francës* (vendim), nr. 69869/01, 1 mars 2005; *Kalender kundër Turqisë*, nr. 4314/02, §§ 42-50, 15 dhjetor 2009). Gjykata po ashtu ka konstatuar se lista e paraqitur më sipër nuk është gjithëpërfshirëse.
37. Tashmë është konstatuar nga Paneli se kjo garanci dhe kriteret procedurale aty parimisht vlejnë për Misionin dhe njëherësh janë relevante për verifikimin e zbatimit të tyre në përputhje me të drejtat themelore të ankuesve. (shih, p.sh., *A, B, C dhe D kundër EULEX-it*, rasti nr. 2012-09, 2012-10, 2012-11 dhe 2012-12, vendimi dhe gjetjet, 20 qershor 2013; *H & G kundër EULEX-it*, rasti nr. 2012-19 & 2012-20, vendimi dhe gjetjet, 30 shtator 2013; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, vendimi për pranueshmërinë, 29 shtator 2015; *D.W., E.V., F.U. G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, vendimi për pranueshmërinë, 30 shtator 2015.; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016, par. 47; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 to 2014-17, vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016). Paneli, megjithatë, e ka bërë të qartë se obligimet që kanë shtetet jo doemos janë të zbatueshme në masën e njëjtë sikur ato që janë të zbatueshme për misionet e sundimit të ligjit, andaj specifikat e këtyre të fundit, për aq sa janë relevante, duhet të merren parasysht në rastin e vlerësimit të respektimit të obligimeve ndaj të drejtave të njeriut nga misioni (shih, në përgjithësi, *L.O. kundër EULEX*, 2014-32, vendimi dhe gjetjet, cituar më lartë, par. 43 dhe 45, dhe referencat tek praktika gjyqësore e Panelit që gjenden aty).
38. Paneli thekson se neni 2 i Konventës mund të nënkuptojë një obligim mbi autoritetet për të ndërmarrë masa opepracionale parandaluese për mbrojtjen e individit, jeta e të cilit është në rrezik nga aktet kriminale të ndonjë individi tjetër (shih GjEDNj, *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i datës 28 tetor 1998, Raportet 1998–VIII). Për të

konstatuar shkelje të obligimit pozitiv për mbrojtjen e jetës, duhet të vërtetohet se autoritetet e kanë ditur, apo është dashur ta kenë ditur në kohë praninë e rrezikut të vërtetë dhe të drejtpërdrejtë ndaj jetës së individëve të identifikuar nga aktet kriminale të një pale të tretë dhe se ata nuk kanë arritur të ndërmarrin masa brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre që, gjykuar arsyeshëm, mund të jenë pritur prej tyre për evitim të atij rreziku (shih, mes autoriteteve të tjera, GjEDNj, *Osman*, cituar më lartë, par. 116).

39. Sa i përket obligimeve procedurale të shtetit, neni 2 i Konventës po ashtu e obligon shtetin që të ndërmerr hetim efektiv rreth shkeljeve të pohuara të pjesës së tij përmbajtësore (shih GjEDNj, *Mastromatteo kundër Italisë* [GC], nr. 37703/97, § 89, GjEDNj 2002-VIII, dhe *Giuliani dhe Gaggio*, [GC], nr. 23458/02, § 298, GjEDNj 2011). Pyetja nëse hetimi ka qenë mjaft efektiv duhet të vlerësohet në bazë të të gjitha fakteve relevante dhe duke e pasur parasysh realitetin praktik të punës hetimore (shih GjEDNj, *Dobriyeva dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 18407/10, § 72, 19 dhjetor 2013). Standardet, prapë, janë pranuar nga Paneli se në parim vlejné për Misionin (shih, p.sh., *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, vendimi dhe gjetjet, cituar më sipër, par. 36; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, vendimi për pranueshmërinë, cituar më sipër).
40. Për të qenë "efektive" meqë kjo shprehje është për t'u kuptuar në kontekstin e nenit 2 të Konventës, hetimet së pari duhet të jenë adekuate (shih GjEDNj, *Ramsahai dhe të tjetër kundër Holandës* [GC], nr. 52391/99, § 324, GjEDNj 2007-II). Pra, hetimet duhet të mundësojnë arritjen deri tek faktet dhe aty ku është e mundur tek identifikimi dhe ndëshkimi i atyre që janë përgjegjës. Obligimi për të kryer hetime efektive nuk është obligim për rezultat, por është obligim për shfrytëzimin e mjeteve: autoritetet duhet të ndërmarrin masat e arsyeshme që i kanë në dispozicion për të siguruar dëshmi në lidhje me incidentin në fjalë (shih GJEDNJ, *Jaloud kundër Holandës* [GC], nr. 47708/08, § 186, GJEDNJ 2014, dhe *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016, par. 36).
41. Obligimi për të vepruar shpejt dhe me përshpejtim të arsyeshëm është i nënkuptueshëm në këtë kontekst (shih GjEDNj, *Al-Skeini dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 55721/07, § 167, GjEDNj 2011; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi dhe gjetjet, cituar më lartë, par. 36; *L.O. kundër EULEX*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, cituar më lartë, par. 46; shih po ashtu Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), vendimi nga Paneli Këshillues për të Drejtat e Njeriut (PKDNj) për rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 80).
42. Përveç kësaj, hetimet duhet të jenë të qasshme për familjen e viktimës deri në masën e nevojshme për ruajtjen e interesave të tyre legjitime (shih, mes autoriteteve të tjera, GjEDNj, *Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 24746/94, § 109, GjEDNj 2001 III dhe *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, cituar më lartë, par. 61 e tutje).
43. Paneli tashmë ka pasur rast që të konstatoj në rastet lidhur me obligimet e kompetencave publike që dalin në lidhje me të drejtën për jetë, se misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se mundësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet në të gjitha aspektet relevante me ato që mund të priten prej shtetit (shih *A, B, C dhe D kundër EULEX-it*, cituar më lartë, krahaso gjithashtu vendimin e PKDNj në rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, par. 42). Tek rasti në fjalë, në lidhje me aspektet operacionale të përgjegjësisë së EULEX-it në lidhje me mandatin e tij ekzekutiv, Paneli nuk do të priste nga Misioni të bënte një hetim të plotë siç do të kishte kërkuar në rastet e pretendimeve për krime të personave të zhdukur dhe të vvarë (shih *L.O. kundër EULEX-it*, referuar më lartë).

Megjithatë Paneli është i mendimit se në rrethanat kur ndonjë dëshmitar i rëndësishëm në ndonjë rast penal vdes, i cili rast penal është ndjekur penalisht nga prokurorë të EULEX-it, qoftë nëse vdekja ka rezultuar në vetëvrasje apo në rrethana të tjera të dyshimta, një hetim i brendshëm i shpejt nga ana e EULEX-it për të konstatuar rrjedhën e ngjarjeve, duke përfshirë në mënyrë kuptimplotë familjen e të vdekurit, do të ishte standardi minimal procedural i pritur që do të ishte në përputhje me obligimet nga neni 2 i Konventës.

44. Më tej Paneli do të theksoj rëndësinë thelbësore të dëshmitarëve për funksionimin e sistemit të drejtësisë penale (shih, në përgjithësi, Këshilli i Evropës, Komisioni i Ministrave, Rekomandimi (2005)9 i Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, 20 prill 2005; shih po ashtu *Maloku kundër EULEX-it*, referuar më lartë, par. 24).
45. Në mënyrë që dëshmitarët dhe “bashkëpunëtorët e tjerë të drejtësisë” të kontribuojnë për atë sistem, të drejtat e tyre themelore duhet të mbrohen në mënyrë adekuate në mënyrë që përfshirja e tyre në proces nuk i ekspozon ata ndaj ndonjë rreziku për dëm. Tashmë Paneli ka theksuar se sa e rëndësishme është që autoritetet kompetente hetimore dhe prokuroriale të sigurojnë që dëshmitarët në rastet penale dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë të mbrohen nga dëmi dhe nga pasoja të tjera negative që dalin nga përfshirja e tyre në procedura penale. Në rastin *W. kundër EULEX-it*, Paneli ka theksuar se përgjegjësia e autoriteteve për mbrojtjen e dëshmitarëve mund të nënkupton në disa raste obligim pozitiv nga anën e tyre që të ndërmarrin masa për të ofruar sigurinë e dëshmitarëve, ndonëse ky obligim nuk duhet të vë barrë të pamundshme apo joproporcionale mbi to (*W. kundër EULEX-it*, nr. 2011-07, 10 prill 2013, par. 48 dhe *Maloku kundër EULEX-it*, referuar më lartë, par. 25).
46. Në lidhje me rrethanat e rastit në fjalë, Paneli thekson se, sa i përket obligimeve substanciale nga neni 2 i Konventës, nuk është pohuar, e lëre më demonstruar, se babai dhe bashkëshorti i ankuesit ka vdekur si rezultat i ndonjë veprimi kriminal nga palët e treta apo si rezultat i përdorimit të paligjshëm apo të tepruar të forcës nga ndonjë autoritet publik. Rezultati i hetimit penal të kryer nga autoritetet e shtetit anëtar të BE-së (shih par. 26 më lartë) në atë se ai ka bërë vetëvrasje, nuk është kundërshtuar në asnjë mënyrë, e as nuk është demonstruar se ka mungesë të kredibilitetit.
47. Paneli më tej thekson se Misioni në aspekte të caktuara nuk ka vepruar me kujdesin e kërkuar në rrethanat veçanërisht të ndjeshme të këtij rasti. Në veçanti, për bindjen e Panelit nuk është demonstruar se Misioni ka shqyrtuar me kujdes nëse veprimet e tij në lidhje me X.F. kanë qenë në përputhje me kornizën ligjore që e rregullon ushtrimin e mandatit të tij ekzekutiv (shih paragrafin 50 më poshtë). Megjithatë, Paneli nuk ishte bindur se këto të meta, në mënyrë individuale apo si tërësi, kanë qenë faktor kontribuues material apo substancial për vendimin e X.F. për ta kryer vetëvrasjen.
48. Në lidhje me këtë, Paneli pranon se neni 2 i Konventës vendos obligime pozitive të caktuara mbi autoritetet publike në lidhje me mbrojtjen e jetës së personave të cenueshëm që janë në kujdes nga shteti apo nën përgjegjësinë e shtetit, si të burgosurit, pacientët e institucioneve mjekësore të mbyllura apo personave në shërbim ushtarak që nuk janë të lirë të dalin (shih, për personat në mbajtje, GjEDNj, *Qendra për burime juridike në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [GC], nr. 47848/08, § 131, GjEDNj 2014; për pacientët e institucioneve mjekësore - *Dodov kundër Bullgarisë*, cituar më lartë dhe për personat në shërbim ushtarak obligativ - *Beker kundër Turqisë*, nr. 27866/03, §§ 41-43, 24 mars 2009). Megjithatë, kjo dispozitë në vetvete nuk garanton të drejtën për mbrojtje efektive substanciale dhe përfundimtare ndaj vetëvrasjes së personit në liri; madje edhe më pak në situatën me të cilën kemi të bëjmë

në rastin aktual, përkatësisht të një personi që qëndron jashtë Kosovës, në një territor të një nga shtetet dërguese; kështu, jashtë shtrirjes së Misionit.

49. Rezulton se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës në pjesën substanciale të tij.
50. Megjithatë, i mbetet Panelit të shqyrtoj nëse EULEX-i i ka përmbushur obligimet e tij procedurale që dalin nga dispozita e njëjtë e Konventës.
51. Në këtë kontekst theksohet se nuk është pohuar, e lëre më demonstruar, se ndonjë hetim i brendshëm është nisur nga EULEX-i me automatizëm dhe me kohë me qëllim të gjetjes së fakteve si dhe mundësisht për përcaktimin e ndonjë përgjegjësie që mund të ngritet nga aty për Misionin pas informimit për vdekjen e X.F. përmes vetëvrasjes. Nuk i takon Panelit t'i specifikoj procedura në strukturën e brendshme të Misionit që do të kishin qenë më të përshtatshme për atë qëllim. Paneli thjeshtë është informuar se një shqyrtim ishte kryer në data të pasaktësuara, periudhë kohore e konsiderueshme pas vdekjes së X.F. (shih par. 6 më lartë). Nuk është pohuar e as demonstruar se ky shqyrtim është bërë nga vet Misioni automatikisht pasi që ishte mësuar për vdekjen e X.F dhe se familja kishte qenë në ndonjë mënyrë e informuar apo e përfshirë në këtë shqyrtim.
52. Andaj ka pasur shkelje të pjesës procedurale të nenit 2 të Konventës.

Neni 3 i Konventës

53. Paneli thekson se kjo dispozitë, për aq sa ajo e ndalon trajtimin çnjerëzor apo poshtërues, po ashtu mund të shkelet nga autoritetet publike edhe në mungesë të ndonjë shkeljeje të integritetit fizik të personit. Për shembull, Gjykata ka konstatuar shkelje të kësaj dispozite në lidhje me një të paraburgosur syzet optike të të cilit i ishin marrë për një periudhë tremujore (shih, GjEDNj, *Slyusarev kundër Rusisë*, nr. 60333/00, 20 prill 2010); në lidhje me të burgosurit që ishin urdhëruar të zhvisheshin para gardianëve të burgut të gjinisë së kundërt (GjEDNj, *Valasinas kundër Lituanisë*, nr. 44558/98, 24 korrik 2001); në rastin e një femre që ishte zhveshur nga punëtorë të gjinisë mashkullore në një qendër për individë të intoksikuar rëndë (shih GjEDNj, *Wiktorko kundër Polonisë*, nr. 14612/02, 31 mars 2009) apo në lidhje me familjet që ishin lënë për kohë të gjatë në gjendje të pasigurt në lidhje me fatin e më të afërmve të tyre që ishin zhdukur në situata të konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar dhe në të cilin rast autoritetet nuk ishin përgjigjur në mënyrë të duhur ndaj pyetjeve të tyre (GjEDNj, *Khamila Isayeva kundër Rusisë*, nr. 6846/02, 15 nëntor 2007).
54. Ngjashëm në këtë rast nuk është në pyetje shkelja e pohuar e integritetit fizik të X.F., por janë rrethanat në të cilat ai e ka gjetur veten para se të vdiste dhe gjendja negative e familjes që ka rezultuar nga to.
55. Paneli thekson se bashkëshorti, përkatësisht babai i ankuesve ka qenë dëshmitar në një rast të rëndë penal. Rreziqet që janë përfshirë kanë qenë mjaft të qarta nga fakti se ishin bërë gjashtë (6) tentim atentate ndaj tij nga kryerës të panjohur (shih paragrafin 15 më lartë) dhe nga vlerësimi i vet Misionit rreth rreziqeve ndaj të cilave ai ishte ekspozuar. Si rezultat, ankuesit dhe X.F. ishin pranuar në një program për mbrojtje të dëshmitarëve, të drejtuar nga EULEX-i (shih paragrafin 16 më lartë).
56. Paneli nuk ka mospajtim në lidhje me këtë vendim. Ai thekson, si rrethanë faktike për çështjet përkatëse në fazën aktuale të procedurës, parashtrësën e ankuesve të bërë në fazën e pranueshmërisë së kësaj lënde se pjesëmarrja e familjes në program ka qenë e vështirë për ta, pasi ata ishin ndjerë të izoluar dhe jeta e tyre e përditshme ishte

penguar, (shih vendimin e pranueshmërisë e datës 13 qershor 2017, par. 47). Kjo ka qenë arsyeja se përse familja kishte dalë nga programi, ndërsa rasti penal kishte mbetur i pazgjidhur. Rreziku i sulmit ndaj familjes, siç ishte vlerësuar nga EULEX-i pak kohë pasi ata kishin dalë nga programi në dhjetor të vitit 2010, vazhdonte të ishte i lartë. Në vlerësimin e sjelljeve të përgjithshme të Misionit dhe kujdesit të ushtruar për këtë çështje, Paneli gjithashtu i merr parasysh të metat e theksuara më sipër, (shih paragrafët 18 & 19 më sipër).

57. Andaj Paneli pranon se X.F. kishte qenë nën stres të madh nga frika për jetën e familjarëve të tij dhe për vet jetën e tij për një periudhë të konsiderueshme kohore, gjatë kohës që kishte kaluar në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe pas tij. Ndonëse kjo gjendje pa dyshim se ishte nxitur, në pjesën më të madhe, nga statusi i tij si dëshmitar në një rast penal të ndjeshëm, Paneli është bindur se mënyra në të cilën Misioni ka vepruar në këtë çështje do të kishte kontribuar po ashtu edhe për mirëqenien e përgjithshme të X.F.
58. Në këtë kontekst, në mars të vitit 2011 është mbajtur një takim para se të kryheshin arrestimet në këtë lëndë penale. X.F. ishte larguar nga Kosova pak kohë më pas në bazë të një vendimi të dhënë – apo të miratuar nga – ky takim.
59. Paneli e vlerëson se ky vendim ishte marrë me qëllim të trajtimit të çështjes se ofrimit të së paku sigurisë minimale për X.F., i cili donte të jepte dëshmi gjatë procedurës penale. Po ashtu Paneli është i informuar mirë rreth faktit se Misioni ishte përballur me zgjedhje të vështirë operacionale të gjetjes së baraspeshës mes interesave të një ndjekjeje penale efektive në një rast kriminal të rëndë dhe sigurimit të dëshmisë së një dëshmitari të rëndësishëm, përderisa ofronte sigurinë e atij dëshmitari. Në lidhje me atë, Paneli konstaton se hapat e ndërmarrë kishin për qëllim mbrojtjen e X.F. nga dëmi. Megjithatë Paneli ka mospajtime me mënyrën në të cilën Misioni ka kërkuar përmbushjen e këtij qëllimi.
60. Në lidhje me këtë, Paneli thekson se EULEX-i është dashur që në atë kohë të ketë qenë në dijeni se X.F. veçse kishte qenë në presion të konsiderueshëm për një periudhë të konsiderueshme kohore, duke u frikësuar për jetën e tij dhe për jetën e familjarëve të tij. Çështja e ofrimit të sigurisë së një dëshmitari që fillimisht ka qenë pjesë e programit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe që pastaj ka vendosur të del prej këtij programi me vetë dëshirën e tij ka qenë e ditur për EULEX-in për një periudhë të konsiderueshme kohore përpara arrestimit të të dyshuarve në muajin mars 2011. Panelit nuk i është treguar se autoritetet e ndjekjes së EULEX-it dhe autoritetet e tjera në kuadër të këtij Misioni kanë shqyrtuar paraprakisht hapat e mundshëm për t'u ndërmarrë në lidhje me sigurinë e këtij dëshmitari dhe familjes së tij në rast se procedurat penale do të shënonin përparim dhe rasti do të arrinte fazën gjyqësore. Po ashtu nuk është treguar se janë bërë përpjekje të duhura dhe të mjaftueshme për ta bërë një planifikim strategjik në lidhje me sigurinë e tyre në planin afatgjatë. Në atë kohë ka mundur të jetë e pritshme që procedurat gjyqësore do të zgjasnin për një periudhë kohore të konsiderueshme, nëse jo për diçka tjetër atëherë për shkak se në këtë rast penal kanë qenë të akuzuar deri dhjetë (10) persona.
61. Me rëndësi, Paneli është i mendimit se kjo detyrë është dashur të kryhej duke i kushtuar vëmendjen e duhur specifikave të mjedisit në Kosovë, që karakterizohet me një shoqëri të ngushtë, në të cilën dhënia e dëshmisë në gjykata mund të perceptohet para së gjithash si mohim i “obligimit për besnikëri” që i detyrohet grupeve kriminale apo klaneve familjare. Tentim atentatet e përsëritura ndaj X.F. vetëm sa e kanë rritur urgjencën e kësaj çështjeje dhe i kanë bërë më të dukshme rreziqet ndaj të cilave ishte përballur ai.

62. Po ashtu, nuk është treguar e as argumentuar se X.F. ishte informuar nga EULEX-i lidhur me rreziqet që përbënte për të ose për familjen e tij vendimi për ta dërguar atë jashtë vendit.
63. Po ashtu nuk është dëshmuar se Misioni e ka bërë vlerësimin e rrezikut për të verifikuar nëse vendimi për ta dërguar X.F. jashtë vendit ishte në përputhje me kornizën ligjore që e rregullon ushtrimin e mandatit ekzekutiv të Misionit, si dhe nëse ishte kryer ky veprim, cilat ishin rezultatet e vlerësimit të rrezikut.
64. Paneli është në dijeni që joligjshmëria e veprimeve të autoriteteve publike nuk i bën në mënyrë automatike këto autoritete përgjegjëse për shkeljen e nenit 3 të Konventës (shih KEDNj-në, *Slyusaryev kundër Rusisë*, par. 34). Megjithatë, ky dështim i qartë për ta adresuar çështjen e ligjshmërisë është një element i qasjes së trajtimit të çështjes së sigurisë së dëshmitarëve, ku në këtë rast Paneli nuk ka si të mos e quaj ndryshe, përpos si të pakujdesshme.
65. E njëjta kritikë vlen lidhur me aranzhimet për udhëtimin, të cilat ishin bërë nga Misioni në mënyrë që ta dërgonin X.F. jashtë vendit, me një njoftim të shpejtë. Mosnjoftimi i autoriteteve të shtetit anëtar të BE-së me kohë dhe paraprakisht lidhur me ngjarjen, nuk mund të thuhet se i shërben qëllimit të ofrimit të sigurisë së X.F.
66. Për më shumë, Panelit nuk i ishte sqaruar mjaftueshëm nëse nga ana e Misionit ishin kërkuar aranzhime specifike rreth sigurisë së tij në shtetin anëtar të BE-së, e lëre më të ishin zbatuar në mënyrë efektive, apo nëse ishin vënë në dispozicionin e tij burime specifike, përveç "një shume të caktuar parash" që i ishin dhënë X.F. nga burimet e Misionit (shih paragrafin 22 më sipër), qoftë gjatë periudhës së parë të tij në shtetin anëtar të BE-së prej muajit mars deri në fillim të korrikut 2011, ose gjatë periudhës së dytë prej një date të pacaktuar në korrik ose gusht 2011 deri në vdekjen e tij më 28 shtator 2011.
67. Gjithashtu, nuk është treguar nëse ishin ndërmarrë hapa konkret pas muajit mars 2011 kur X.F. ishte larguar nga Kosova dhe gjatë muajve përpara vetëvrasjes së tij dhe pas kësaj për ta përcaktuar dhe adresuar në çfarëdo mënyre gjendjen dhe sigurinë e familjes së tij.
68. Shkurt, X.F. i ishte ekspozuar një periudhe të gjatë frike, paqartësie dhe ankthi për sa i përket fatit të tij dhe familjes së tij, pa i pasur burimet adekuate dhe ndihmën e duhur. Kjo ka çuar deri te një situatë tepër të rrezikshme, si për të ashtu edhe për familjen e tij.
69. Paneli në këtë drejtim ripërtëritë se përderisa rrethanat rreth statusit të tij si dëshmitar në një lëndë të ndjeshme penale kanë ndikuar seriozisht në gjendjen e jetës së tij, po ashtu veprimet e Misionit ishin tejet relevante për gjendjen e përgjithshme të mirëqenies së X.F. dhe familjes së tij, në atë masë sa ata vërtetë kanë mundur të ndjejnë ankth dhe frikë për jetën dhe sigurinë e tij. Marrë parasysh çfarë u përmend më sipër, Paneli nxjerr në përfundim se, në veprimet balancuese që janë shumë të rëndësishme për çështjet e përfshira në situatën e X.F. si dëshmitar, i cili i ishte ekspozuar kërcënimeve ndaj sigurisë dhe jetës së tij, si dhe sigurisë dhe jetës së familjarëve të tij, nuk është treguar që siguria dhe mirëqenia e tyre ishte marrë parasysh në mënyrë të mjaftueshme.
70. Prandaj është bërë shkelje e nenit 3 të Konventës në lidhje me X.F. dhe ankuesit.

PËR KËTO ARSYE, PANELI, NJËZËRI,

- *Vendos* që nuk është bërë shkelja e nenit 2 të Konventës në pjesën përmbajtësore të tij;
- *Konstaton* se është bërë shkelje e nenit 2 të Konventës në pjesën procedurale të tij;

- *Konstaton* se është bërë shkelje e nenit 3 të Konventës marrë parasysh se ajo e ndalon trajtimin çnjerëzor apo poshtërues;

DEKLARON se në bazë të gjetjeve faktike dhe ligjore të mësipërme është e përshtatshme që shëfës së Misionit t'i bëhen rekomandime dhe

I REKOMANDON VEPRIMET KORRIGJUESE SI NË VIJIM:

- SHM-ja duhet ta bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit përbëjnë shkelje të të drejtave të ankuesve që i atribuohen veprimeve dhe mosveprimeve të EULEX-it gjatë kryerjes të mandatit të tij ekzekutiv;
- SHM-ja duhet të shpërndaj këtë vendim lidhur me substancën e këtij rasti tek personeli i Misionit, detyra e të cilëve ka të bëjë me çështjen e këtij rasti, në mënyrë që të ofrohen udhëzime lidhur me standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese